REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

MARS – MARCH
2005

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Mars 2005

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…….13
   d. SEKTORI MONETAR……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Mars 2005, arriti ne 108.7 perqind, duke shenuar nje rritje mujore prej 0.01 përqind, pas rritjes me 0.4 perqind dhe 0.8 perqind, perkatesisht ne muajt shkurt dhe janar 2005. Norma vjetore e inflacionit, ne muajin Mars, ishte 1.6 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise, ne intervalin 2 - 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** per muajin Mars 2005, ishte:

  - 95.84 leke per dollare
  - 126.44 leke per euro



Ne muajin mars konstatohet nje mbicmim i lehte te monedhes sone kombetare, ndaj dollarit amerikan dhe nje ecuri me te qendrueshme kundrejt monedhes europiane. Ky eshte reflektim i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare.

Gjate muajit dhjetor 2005, **normat e interesit te depozitave** 12 mujore ne leke, kane pesuar nje renie ne vlere absolute prej 0.14 perqind krahasuar me nje muaj me pare, duke vazhduar ne kete menyre trendin e tyre renes gjate kesaj periudhe te vitit. Kjo ecuri eshte rrjedhoje e politikave te ndermarra nga Banka e Shqiperise, ku mund te permendim ate te uljes se normes baze te interesit. Nje faktor tjeter qe ka ndikuar ne uljen e normave te interesit te depozitave ne leke ka qene edhe teprica ne likuditete ne ekonomine shqiptare. Renien me te ndjeshme gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore, me rreth 1.63 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



	Dhje '03	Jan '04	Shku '04	Mars '04	Prill '04	Maj '04	Qer '04	Korr '04	Gusht '04	Shtat '04	Tet '04	Nent '04	Dhje '04
12-M	7.62	7.33	7.09	7.03	6.93	6.76	6.96	6.39	6.27	6.26	6.13	6.13	5.99
6-M	7.07	6.82	6.61	6.57	6.63	6.30	6.10	6.01	5.85	5.79	5.63	5.58	5.41
3-M	5.49	5.26	5.06	5.21	5.24	5.06	4.89	4.88	4.89	4.83	4.76	4.69	4.48

Renie ka patur edhe ne depozitat me afat 6 mujor dhe 3 mujor. Keto depozita, krahasuar me nje muaj me pare, kane pesuar nje renie te lehte respektivisht me 0.17% dhe 0.06%.

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Mars 2005, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth 1.41 miliarde leke, ose rreth 3.35 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2005.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 45.4 miliarde leke ose rreth 21.98 perqind e programit vjetor 2005.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 46.8 miliarde leke, ose rreth 18.83 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2005.



- **Deficiti i pergjithshem** arriti ne 1,414 milion leke nga 2,732 milione leke te parashikuar per kete periudhe 3-mujore, duke perballuar ne kete menyre kryerjen e shpenzimeve ne kohen e duhur.

- **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 21.98 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

  - Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 21.5 përqind të programimit vjetor;
  - Kontributet për sigurimet shoqërore, prej 23.21 përqind;
  - Të ardhurat jo-tatimore me rreth 20.91 përqind e buxhetit vjetor; dhe
  - Të ardhurat nga pushteti lokal, me rreth 33.36 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 18.83 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 41,968 milione lekë ose rreth 21.76 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 23.56 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale, me rreth 22.95 përqind e buxhetit vjetor dhe te shpenzimeve të larta operative dhe te mirembajtjes me rreth 20.46 perqind te buxhetit vjetor.

- **Bilanci i pagesave**

Bilanci i pagesave per muajin Dhjetor, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 43.1 milion dollare. Kjo ishte rezultat i nje:

  - defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 108 milion dollare;
  - suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej rreth 11.1 milion dollare;
  - sufiçiti te Llogarise Financiare, prej rreth 78.1 milion dollare;
  - bilanci pozitiv ne "Gabime dhe Harresa neto" prej rreth 61.9 milion dollare.



- Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 108 milion $ ishin nje:

  - bilanc tregtar negativ prej 203.4 milion dollare;
  - defiçit prej 22.3 milion dollare ne bilancin e sherbimeve;
  - suficit prej 12.8 milion dollare ne bilancin e te ardhurave;
  - suficit prej 104.9 milion dollare ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.



Në baze kumulative, në fund të vitit 2004, bilanci i pagesave rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 288 milionë dollare.

Komponentët kyç ishin:

  - defiçiti prej 404.2 milionë dollare, në llogarinë korrente,
  - sufiçiti prej 132.2 milionë dollare ne llogarine kapitale,
  - suficiti prej 398.6 milionë dollare në llogarinë financiare,
  - bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej 161.4 milionë dollare.

- **Oferta totale e parasë,** e matur nga M3 arriti në 507.2 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor, duke shenuar një rritje me rreth 13.1 perqind ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar



- Kjo rritje erdhi si rrjedhoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 77.8 perqind, depozitave ne valute me rreth 15.8 perqind, depozitave me afat ne leke

me rreth 6.7 perqind dhe rritje te parase jashte sistemit me rreth 10.3 perqind, krahasuar me nje vit me pare.



2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit per muajin Mars, pati nje ulje prej 0.01 perqind, krahasuar me rritjet ne muajt Shkurt dhe Janar 2005, perkatesisht me 0.4 dhe 0.8 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin 0.1 perqind, 1.9 perqind dhe - 0.2 perqind.

Kjo ulje prej 0.01 perqind e indeksit te çmimeve te konsumit per muajin Mars erdhi si rezultat i uljes se indeksit te grupit "Veshje dhe kepuce" prej 0.3 perqind, ndikuar nga ndryshimi i sezonit.

Ulje, ne kete muaj pesoi, edhe grupi "Ushqim dhe pije joalkolike" me 0.2 perqind. Ne kete grup, uljen me te madhe e shenoi nengrupi "zarzavate perfshire patatet" me rreth 5.6 perqind.

Gjate ketij muaji, grupi "Transport" shenoi nje rritje prej 0.8 perqind, ku mund te permendim rritjen e cmimit te karburantit me 2.6 perqind, cmimit te biletave te transportit me mikrobuze, prej 3.7 perqind dhe cmimit te biletave te avionit, me 2 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Mars arriti ne 1.6 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2004 dhe 2005 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nen	Dhj.
2005	3.3	1.8	1.6									
2004	3.3	4.4	4.0	3.2	2.6	2.9	3.1	2.7	2.0	2.0	2.2	2.2

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, gjate muajit Mars 2005, pesoi renie ne krahasim me nje muaj shkurt. Ne fund te muajit mars, kursi kembimi arriti ne 97.05 leke/dollare, nderkohe qe mesatarja mujore arriti ne 95.84 Leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit per Euron ne muajin Mars arriti ne 126.44 Lek/Euro, duke shenuar nje renie te lehte prej 0.17 perqind, krahasuar me nje muaj me pare, ndersa ne fund te muajit Mars, nje Euro u kembye me 125.71 Leke

Gjate ketij muaji u konstatua nje mbicmim i lehte i lekut kundrejt dollarit amerikan dhe nje ecuri me te qendrueshme kundrjet Euros. Kursi mesatar i dollarit arriti ne 95.84 Leke/USD ne muajin Mars, ose rreth 1.5 perqind me i ulet, ne krahasim me muajin Shkurt.

Ne krahasim me muajin Mars te vititi te kaluar, rezulton se monedha shqiptare eshte mbicmuar ndaj dollarit amerikan, ne rreth 9.9 perqind dhe kundrejt monedhes europiane, rreth 3.1 perqind.



Ndikimin me te madh ne ecurine e kursit te kembimit te dollarit amerikan e ka luajtur faktori i jashtem, gje qe ka reflektuar ecurine e tyre edhe ne tregun tone valutor. Ne tregjet nderkombetare, kembimi i euros me dollarin amerikan ka qendruar ne nivelin 1.3 dollare/euro.

Interesi i huave 12-mujore ne muajin dhjetor u ul me rreth 1.32 perqind, duke arritur ne 13.73 perqind nga 15.05 perqind qe ishte nje muaj me pare. Te njejten kah renes pati edhe per interesin e huave 6-mujore, duke ndryshuar me 1 perqind, krahasuar me muajin e kaluar. Interesi i huave 6-mujore per muajin dhjetor arriti 10.98 perqind



Normat e interesit te Bonove te Thesarit per muajin nentor per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin 8.13 perqind, 7.26 perqind dhe 6.32 perqind. Gjate ketij muaji ato pesuan nje renie te lehte ne krahasim me muajin tetor, respektivisht normat e interesit te bonove me maturim 12 mujor u ulen me 0.14 perqind, bonot me maturim 6 mujore u ulen me 0.05 perqind dhe per ato me maturim tremujor u ulen me 0.14 perqind.

b. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Mars, jane mbledhur rreth 45,400 milione leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 46,814 milione leke, qe perfshijne 41,968 milione leke ne shpenzime korente dhe 4,845 milione leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e 1.41 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 21.98 % te te ardhurave buxhetore per vitin 2005, ndersa shpenzimet perbejne 18.83 % te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 21.76 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 9.59 % e ketij planifikimi.

Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 29,077 milione leke (ose rreth 21.50 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 3,454 milione leke (33.36 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 8,511 milione leke (23.21 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 3,629 milione leke (20.91 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 41,968 milione leke, 12,036 milone leke (29 %) eshte shpenzuar per personelin, 7,036 milione leke (17 %) per interesat, 4,491 milione leke (11 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 598 milione leke (1 %) per subvencione, 12,659 milione leke (30 %) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe 5,148 milione leke (12 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 21.79 % (shpenzime personeli), 23.56 % (shpenzime per interesat), 20.46 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 21.85 % (subvencione), 22.95 % (sigurimet shoqerore), 16.82 % dhe 21.26 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 4,845 milione leke, nga te cilat 39 % financim i brendshem, dhe 61 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem, llogariten per kete periudhe ne rreth 6.79 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 13.06 %.

Deficiti prej 1,41 milione leke eshte i barabarte me 3.35 % te deficitit buxhetor per 2005.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Mars 2005 ne rreth 45,400 milione lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 41,041 milione, grantet 729 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 3,629 milione;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 29,077 milione lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 3,454 milione lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 8,511 milione leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të muajit Mars permendim:

- TVSH 13,454 milionë lekë
- Tatimi mbi fitimin 4,867 milionë lekë
- Taksa doganore 2,844 milionë lekë
- Taksat nacionale 1,928 milionë lekë
- Akcizat 3,435 milionë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 804 milione lekë;

Financimi i deficitit

Deficiti prej 1.41 miliardë lekë, ne fund te mars, ishte -121 përqind me financim të brendshëm dhe 17 përqind me financim të huaj. Te ardhurat nga privatizimi dhe emetimi i bonove të thesarit ishin mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për muajin Dhjetor ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem, prej 43.1 milion dollare, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 108 milion dollare ;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 11.1 milion dollare ;
- sufiçit te Llogarise Financiare, prej 78.1 milion dollare ;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 61.9 milion dollare .

Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 108 milion dollare ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 203.4 milion dollare ;
- defiçit prej 22.3 milion dollare ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 12.8 milion dollare ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 104.9 milion dollare ne levizjet e transfertave dhe dergesave.

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investimeve direkte prej 19.8 milionë dollare,
- flukset negative të investimeve në investimet fizike prej 93.8 milionë dollare
- flukset pozitive të kapitaleve të tjera prej 152.1 milionë dollare.

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate 12-mujorit te 2004, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, me rreth 612.8 milione dollare krahasuar me fundin e vitit 2003.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 161.2 milione usd, nderkohe qe mjetet valutore neto te B.Sh. jane rritur me 451.6 milione dollare.

Pjesa me e madhe e kesaj rritjeje ka ardhur kryesisht nga mbicmimi i euros ndaj dollarit amerikan ne tregun nderkombetar, prania e Bankes se Shqiperise ne tregun valutor ne kahun e blerjes se valutes, rritja e depozitave ne valute prane bankave të nivelit të dyte, si dhe konvertimi ne valute i kapitalit të bankes Raiffeisen .

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te vitit 2004 arriti ne 70 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise gjate kesaj periudhe te vitit shenoi vleren 19.3 miliardë leke, duke perbere nje rritje prej 37 për qind në krahasim me fundin e vitit 2003.

Nga struktura e teprices se kredise sipas afateve verehet nje rritje e peshes se kredive afatmesme dhe afatgjata. Në fund të vitit 2004, teprica e kredise afatmesme dhe afatgjate perbente 66.0 perqind te teprices se kredise gjithsej. Teprica e kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere 80 perqind te totalit te treprices se kredise. Karakterisike per tregun e huadhenies bankare, gjate vitit 2004, ishte rritja e levrimit të kredive të reja ne leke. Gjate muajit dhjetor u levrua kredi e re 10.9 miliarde leke nga e cila 27 perqind eshte levruar ne leke.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin dhjetor ka shenur nje rritje prej 2.4 perqind karahasuar me muajin nentor. Kjo oferte kapi shifren rreth 507.2 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 13.1 perqind. Rolin kryesor në këtë rritje e kane dhene depozitat ne leke, te cilat kane pesuar nje rritje mujore me rreth 4.3 miliarde leke, nderkohe qe niveli i parase jashte bankave eshte rritur me 9.2 miliarde leke dhe niveli i depozitave ne valute eshte ulur me 1.4 miliarde leke ne krahasuar me nje muaj me pare.



	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tet	Nent	Dhje
Series1	26.9	26.5	25.7	25.7	25.5	25.8	26.4	26.6	25.9	25.9	26.0	27.2
Series2	36.8	36.1	34.6	34.6	34.1	34.8	35.9	37.3	35.4	35.0	35.2	37.4

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, gjate muajit dhjetor arriti ne 27.2 perqind, duke shenuar nje rritje krahasuar me muajt e meparshem. Megjithate ky tregues paraqet qendrueshmeri, duke reflektuar kryesisht stabilitetin financiar të arritur dhe prezencen e normave pozitive të interesit real ne dy vitet e fundit.

Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin dhjetor arriti ne rreth 37.4 perqind.

Depozitat ne leke si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje prej 1.7 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ecuria e kenaqshme e tyre eshte rezultat i rritjes se kerkeses për mjete monetare ne leke dhe rritjes se besimit ne monedhen vendase. Depozitat në valutë, kanë shfaqur një renie te lehte prej 1.2 perqind krahasuar me muajin nentor.

Depozitat sipas Burimeve

Kjo tabelë tregon përbërjen e depozitave te cilat kontribuojnë në përkufizimet e ndryshme të ofertës së parasë (Tabela 15) sipas llojit të depozituesve.
Një shqyrtim i tabelës tregon se gjate 12-mujorit 2004:

➢ Sektori i individeve zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me 39.4 perqind, ndjekur nga sektori privat me 36.2 perqind dhe nga ndermarjet jofinanciare publike me 17perqind.

➢ Individet, si edhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 46.5 perqind dhe 41.1 perqind.

➢ Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.2 përqind e totalit) dhe depozitave me afat në monedhe të huaj (me 91.6 përqind e totalit te depozitave;

➢ Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 84.2 përqind) të depozitave totale prej 369 miliardë lekësh ne muajin dhjetor 2004. Ata ndiqen nga sektori privat (10.5 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (4.2 përqind) dhe autoritetet lokale (0.6 përqind). Institucionet financiare kontribuan me 0.6 për qind ne totalin e depozitave.



➢ Gjatë muajit Dhjetor 2004, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 2.8 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave pa afat në lekë (6.4 miliardë lekë), depozitave me afat ne monedhe te huaj (0.45 miliard leke), si dhe renies se depozitave me afat ne leke (2.2 miliard leke) dhe depozitave pa afat ne valute (1.9 miliarde leke).

➢ Depozitat pa afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 5.5 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familjareve gjate muajit dhjetor u ulen me rreth 2.5 miliarde leke.